



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 18 mars 2015, në mbledhjen e parë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.00

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z.Isak Ejupi, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Radisav Perović , përfaqësues i Komunitetit serb; z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit për Komunitete; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Nexhmi Rudari, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Sami Ajeti, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit në Nivel komunal; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z. Faik Muçiqi, përfaqësues i Emergjencave Civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim; z. Bunjamin Hoti, përfaqësues i OJQ-ve; z.Fadil Halimi, përfaqësues i Mediave lokale; z.Avni Shabani, përfaqësues i Komunitetit të biznesit dhe z. Idriz Hoxha, përfaqësues i komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa munguan: z. Bekim Jashari, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame dhe z. Sabedin Rama, përfaqësues i Komunitetit rom;

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: z. Laslo Banásagi, major, shef i LMT-së, përfaqësuesit e EULEX-it dhe përfaqësuesit e Zyrës së UNMIK-ut.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, Mirë se keni ardhur, më lejoni të hapi mbledhjen e KKS-së, materialet për rendin e ditës besoj se i keni marrë me kohë. Nëse jeni dakord mund të fillojmë me punë.

1. Rend i propozuar i ditës

U miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 30 janar 2015.

U miratua njëzëri

3. Raporte të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it për gjendjen e sigurisë në Komunë

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fillimisht fjalën ia japim Komandantit të Stacionit të Policisë z. Isak Ejupit.

z. Isak Ejupi, bazuar në raportet që vijnë në Stacionin Policor në Podujevë dhe të dhënat që ne i grumbullojmë nga terreni situata e sigurisë në periudhën e kaluar ka qenë e qetë dhe stabile, nuk kemi pas incidente as të karakterit ndëretnik, nuk ka pas incidente serioze të cilat e rrezikojnë rendin dhe sigurinë publike, ndërkohë që Policia vazhdon ti kryejë obligimet e veta karshi përpjekjeve tona për krijimin e sigurisë të qëndrueshme dhe të stabilitetit në zonën tonë të përgjegjësisë. Mund të ju them se për periudhën vijuese në bazë të analizave që ne i kemi dhe në bazë të referencave që vijnë nga

institucionet e sigurisë por edhe nga bashkëpunëtorët tonë në terren nuk kemi indikacione se në përdhën vijuese do të ketë ndonjë situatë e cila do të çrregullojë rendin dhe sigurinë publike. Duke vlerësuar shumë pozitiv përfundimin e vitit të kaluar dhe rezultatet që i kemi arrit bashkërisht, unë i thërras të gjithë që të punojnë në kontinuitet në krijimin e sigurisë në të gjitha nivelet dhe në përpjekje për të konsoliduar radhët, sidomos në zonat rurale. Me 6 dhe 12 shkurt i kemi themeluar dy KLSP njëren në fshatin Orllan dhe tjetren në fshatin Kërpimëh që besoj se do të jenë mekanizma që do ta ndihmojnë dhe do të bashkëpunojnë ngushtë me Policinë në përpjekje për të krijuar rend dhe rregull dhe për të mbrojtur pronën dhe jetën e qytetarëve në ato zona. Unë kam përfshirë statistikën që kanë të bëjnë periudhën vijuese por edhe në raport me vitin paraprak nga të cilat shihet se trendi i rënies së krimit në Komunën e Podujevës po vazhdon dhe kjo të bën për të kuptuar se jemi në rrugë të mirë dhe për këtë i falënderoj të gjitha institucionet që ne bashkëpunojmë dhe që kanë dhënë një kontribut në arritjen e këtyre rezultateve dhe unë shpresoj që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ne kemi përmbyllë Planin operativ 2014-2015 dhe jemi në përgatitje të Planit operativ vera 2015 në të cilin inkorporohen shumë kategori për të cilat ne do ta përqendrohemi, duke theksuar të shtënat nëpër ahengje dhe dasma. Unë pres që këtë vit duke përfshirë edhe ju që të jeni kontribues në përpjekje për të parandaluar të shtënat, të cilat rrezikojnë sigurinë e njerëzve. Unë ju falënderoj për vëmendjen, nëse keni ndonjë pyetje jam në dispozicion të përgjigjem.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, falënderojmë Komandantin për paraqitjen e raportit lidhur me gjendjen e sigurisë në Komunë, ndërsa në vazhdim fjalën e ka përfaqësuesi i KFOR-it.

z. Laslo Banágy, theksoi, KFOR-i situatën në Komunë e vlerëson të qetë dhe stabile, megjithatë kam disa shqetësime. Ekipet e mia i kanë vizituar të gjitha shkollat në rajonin e Podujevës dhe disa nga drejtorët e shkollave janë ankuar për qentë endacak. Duhet bërë diçka sa i përket këtij problemi, ngase kryesisht fëmijët po rrezikohen nga qentë endacak. Pothuaj çdo javë kam takim me komandantin e Stacionit të Policisë dhe nga ai marr të dhënat statistikore dhe jam shumë i kënaqur për faktin se krimi është në rënie. Shtoi, në këtë kontekst jam i njoftuar se është mbajtur një takim mes Policisë dhe imamëve të rrethit të Llapit për temën sigurinë në trafik.

Agim Veliu, Kryetar i Komunës, faleminderit, e hapi mundësinë e diskutimit lidhur me raportin e Policisë dhe KFOR-it për gjendjen e sigurisë. Nëse nuk keni diçka për të shtuar unë falënderoj Komandantin dhe përfaqësuesin e KFOR-it për informacionet dhe raportet e paraqitura. Më gëzon fakti se të dhënat në raportin krahasues të Komandantit të Policisë janë të mira dhe shihet se numri përgjithshëm në të gjitha veprat ka rënie, kjo është shumë e rëndësishme për Komunën tonë dhe unë e falënderoj Komandantin për punën që po e bën me ekipin e tij por edhe për bashkëpunimin e mirë që e kemi në raporte zyrtare. Për çështjen që e ngriti përfaqësuesi i KFOR-it, është e vërtetë se edhe Komuna e Podujevës ka problem me qentë endacak. Ne kemi bërë përpjekje ta kemi në kontroll këtë situatë, mirëpo për shkak të pamundësive buxhetore edhe të rregullativës ligjore ende nuk po krijohen mundësitë që këtë çështje ta vumë në kontroll plotësisht. Ne për shkak të gjendjes, që na është paraqitë edhe nga Policia por edhe nga përfaqësuesit e fshatrave, kemi zhvilluar procedurë në mënyrë që në një masë situatën ta vejme nën kontroll, mirëpo ka pas reagime të ndryshme prej shoqatave të ndryshme që merret me mbrojtjen e kafshëve, kështu që kemi anuluar vendimin. Na është premtuar nga shoqatat e ndryshme që do të gjejnë donator që Komuna e Podujevës të përkrahët në atë drejtim, mirëpo ende nuk ka diçka konkrete, por për fat të mirë nuk e kemi ndonjë rast që është me pasoja për sa i takon qenve endacak. Nëse nuk keni diçka për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

4. Miratimi i propozimit të Planit të punës të KKS-së për vitin 2015

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, meqë është mbledhja e dytë e KKS-së kemi planifikuar miratimin e Planit vjetor të punës. Sa i përket propozimit të Planit të përgatitur nga Grupi punues të shohim nëse dikush ka ndonjë vërejtje, sugjerim apo plotësim të propozimit. Më hollësisht rreth propozimit do të elaborojë z. Faik Muçiqi, kryesues i grupit punues.

z. Faik Muçiqi, elaboroi në detaje të gjitha punët dhe aktivitetet e KKS-së të planifikuara sipas propozimit të Planit të punës së KKS-së për vitin 2015.

z. Isak Ejupi, unë veç paralajmërova një aktivitet e që ka të bëjë drejtpërdrejt në nivelin e sigurisë për qytetarët tanë e që janë të shtënat me armë zjarri, e që sigurisht në takimin e radhës do ta elaborojë më gjerësisht këtë situatë. Në këtë rast çdo mekanizëm duhet të pozicionohet karshi kësaj shtate sepse ne veç në vitin 2012 i kemi pas 4 qytetarë të plagosur nga plumbat qorr, kështu që është fat i mirë që në

vitin 2014 nuk kemi pas raste të tilla, por kjo nuk do të thotë se nuk do të ketë nëse vazhdojnë këto të shtëna që me të vërtetë janë imazh i keq jo vetëm për vendin por që shkaktojnë rrezikim të sigurisë për vendin. Jam i interesuar që kjo kategori në mënyrë të veçantë të futet në kuadër të Planit të punës së KKSB-së, në mënyrë që ne të bëjmë më shumë për këtë kategori dhe të parandalojmë këtë dukuri e shprehur sidomos gjatë sezonit të dasmave. Në kontekst të kësaj ne do të përpiqemi të organizojmë një takim me imamët e Xhamive në mënyrë që këtë ta kenë si temë dhe ta shpërndajnë te xhemati, që të ndikohet në këtë aspekt.

z. Bunjamin Hoti, theksoi, ne kemi dërguar dy projekte për çështjen e sigurisë në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit. Njëra ka të bëjë lidhur me të shtënat sidomos gjatë sezonit të verës, gjatë kohës së dasmave dhe tjetra për festat e fundvitit, që të jet një sensibilizim i qytetarëve lidhur me kontrollimin e të shtënave me fishekzjarrë apo mjete tjera piroteknike

z. Liman Zeqiri, në kuadër të propozimit të Planit të Punës së KKSB-së siç shihet është zgjerimi i shtratit të lumenjve, që është një prej temave të rëndësishme, që domosdo duhet trajtuar, në aspektin e sigurisë publike. Dua të theksoj se në këtë aspekt ne vet qytetarët jemi fajtor për ngushtimin e shtratit të lumenjve. Si pasojë e kësaj vjen në shprehje siguria e qytetarëve, ku më së shumti rrezikohen nxënësit ngase në shumë vende ata kanë problem për tejkalimin e lumenjve. Është mirë që në të ardhmen ta kemi parasysh këtë pikë, që shtretërit e lumenjve të zgjerohen, pra përpos zjarreve edhe vërshimet ta trajtojmë si temë të veçantë, ku edhe figuron në Planin e punës.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, ne me buxhetin e Komunës kemi ndarë mjete për dy çështje që u ngritën, njëra për rregullimin e trotuareve dhe tjetra për pastrimin dhe zgjerimin e shtretërve të lumenjve dhe jemi në fazën e zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Konstatim:

Propozimi i Planit të punës së KKSB-së për vitin 2015, pas votimit, me plotësim të pikës së propozuar nga Komandanti i Policisë njëzëri rekomandohet për miratim në kuvendin e Komunës.

Propozimi i Planit të Punës së KKSB-së për vitin 2015 është pjesë përbërëse e procesverbalit.

5. Informatë për aktivitetet KKSB-së në vitin 2014

Agim Veliu, Kryetar i Komunës, Informata e paraqitur, e përgatitur nga Grupi punues, sipas Udhëzimit Administrativ përkatës do të procedohet në Kuvend, për informim rreth punës dhe aktiviteteve të KKSB-së për vitin 2014.

6. Të ndryshme

Nuk pati diskutime

Kryetari përfundoi mbledhjen pasi që nuk pat çështje tjera për shqyrtim, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën 10.35

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani

Nr. 02-006-35635

Podujevë,

18 mars 2015

Kryetari i Komunës

Agim Veliu